

DORACAK PËR ZHVILLIMIN E STUDIMEVE THEMELORE (BACHELOR) DHE POSTDIPLOMIKE (MASTER)

Autorët:

Heribert Aigner, Doris Carstensen, Helmut Eberhart Philipp Funovits, Helmut Guttenberger, Maximilian Jung, Ulrike Krawagna, Joachim Ninaus, Johannes Passini, Gudrun Salmhofer, Gabriele Schmölder, Ursula Schneider, Andreas Szeberenyi dhe Wolfgang Weirer

DORACAK PËR ZHVILLIMIN E STUDIMEVE THEMELORE (BACHELOR) DHE POSTDIPLOMIKE (MASTER)¹

Versioni i 27 qershorit 2007

Autorët:

*Heribert Aigner, Doris Carstensen, Helmut Eberhart
Philipp Funovits, Helmut Guttenberger, Maximilian Jung,
Ulrike Krawagna, Joachim Ninaus, Johannes Passini,
Gudrun Salmhofer, Gabriele Schmölder, Ursula Schneider,
Andreas Szeberenyi dhe Wolfgang Weirer*

*Përkthimi dhe përshtatja në gjuhën shqipe: But Dedaj,
Mjellma Carabregu, WUS Austria, Prishtinë dhe Florita
Raifi, zyrtare për zhvillim të kurrikulit në Universitetin e
Prishtinës*

¹ Ky Doracak është zhvilluar nga Universiteti i Grazit (Austri). Ndryshimi i terminologjisë dhe përfshirja e termave bachelor dhe master në bazë të BGB (Gazeta Zyrtare e Ligjit Federal të Republikës së Austrisë). I, Nr. 74/2006.

Impressum:

Publikuar nga: **WUS Austria**
Redaktor: **But Dedaj dhe Mjellma Carabregu (WUS Austria) dhe Florita Raifi (Universiteti i Prishtinës)**
Dizajni: **Ringeis promotion**
Shtypur nga: **Dizajn studio Ringeis**
Numri i Kopjeve: **200**

Copyright: © **Karl-Franzens Universiteti i Grazit**

Kopjen elektronike e këtij Doracaku mund ta gjeni edhe në këtë adresë elektronike: www.wus-austria.org

Publikimi i këtij Doracaku u financua nga: Agjensioni Austriak i Zhvillimit.

Doracak për zhvillimin e studimeve të rregullta (bachelor) dhe post-diplomike (master)

P ë r m b a j t j a

2.	Bazat themelore të kurrikulit modular	9
3.	Zhvillimi profesional dhe përmbajtësor i kurrikulit	17
4.	Studimi në kuadër të sistemit ECTS (engl. European Credit Transfer and Accumulation System)	23
5.	Rregullorja për provime	27

Hyrje

Shpresojmë që ky doracak do t'u ofrojë ndihmë dhe do të jetë shoqërues i vlefshëm gjatë zhvillimit të kurrikulit në Universitetin e Prishtinës. Vlen të përmendet se Doracaku nuk ka karakter detyrues dhe me këtë nuk tenton të ndërhyjë në aspektin përmbajtjesor në Senat dhe në komisionet për kurrikul.

1.1. Procesi i Bolonjës

Me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës, 40 shtete evropiane janë zotuar se, deri në vitin 2010, do të krijohet një zonë dinamike dhe konkurrense e arsimit të lartë (eng. EHEA - European Higher Education Area). Procesi i Bolonjës është i orientuar në drejtim të zbatimit të transparencës së bazuar në krahasueshmërinë e niveleve arsimore, e jo parimisht në barazimin e tyre.

Procesi i Bolonjës është përgjegjësi e Universitetit

Baza e këtij procesi është themeluar në nivelin evropian me nënshkrimin e Deklaratës, si dhe me konferenca të ministrave evropianë të Arsimit, të cilat mbahen çdo dy vjet. Në nivelin nacional, në shumicën e shteteve, është nxjerrë korniza përkatëse ligjore për hyrjen në fuqi të reformave, përderisa për vetë zbatimin e reformave dhe për synimet e tyre kanë përgjegjësi vetë universitetet.

Harmonizimi struktural

“Arkitektura e studimeve” evropiane me nivele të studimeve themelore (bachelor), postdiplomike (master) dhe të doktoratës (PhD) duhet t'i shërbejë krahasueshmërisë strukturale dhe harmonizimit të diplomave universitare. Qëllimi nuk është të krijohet ngjashmëria përmbajtjesore, por shumëllojshmëria në Evropë.

Dhjetë fusha të veprimit

Fushat e veprimit të Deklaratës së Bolonjës së vitit 1999 janë të përfshira në konferencat e mbajtura në Pragë (2001), në Berlin (2003), në Bergen (2005) dhe në Londër (2007). Këto fusha momentalisht përmbajnë:

1. Përfshirjen e sistemeve lehtë të kuptueshme dhe të shkallëve të krahasueshme - përfshirjen e të ashtuquajturave “Shtojcë e diplomës” (eng. Diploma Supplement);

2. Përfshirjen e sistemeve të themeluara në dy cikle: themelore dhe postdiplomike;
3. Përfshirjen e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (eng. European Qualification Framework);
4. Përfshirjen e sistemit të notimit për promovimin më të gjerë të mobilitetit të studentëve (eng. ECTS – European Credit Transfer System);
5. Të mësuarit/të nxënës gjatë gjithë jetës;
6. Promovimin e bashkëpunimit evropian në fushën e sigurimit të cilësisë, në aspektin e zhvillimit të metodave dhe kritereve të krahasueshme;
7. Promovimin e mobilitetit të studentëve, të arsimtarëve, të hulumtuesve dhe të personelit administrativ;
8. Promovimin e dimensionit evropian për arsimin e lartë, veçanërisht në aspekt të zhvillimit të kurrikulit, të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të mobilitetit;
9. Rritjen e atraktivitetit dhe të konkurrencës së Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë; dhe,
10. Studimet e doktoratës dhe themelimi i Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe të Hulumtimit.

Krijimi i kornizës përkatëse ligjore është parakusht për arritjen e synimeve të cilat nënkuptojnë transparencë të strukturave të ndryshme evropiane dhe fuqizimin e konkurrencës së Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë dhe të Hulumtimit.

Rritja e mobilitetit të studentëve i kontribuon mundësisë së përfshirjes së ligjëratave² dhe përmbajtjes ndërkombëtare në gjuhët e huaja në kurrikul, gjë që mundëson kualifikimin e përgjithshëm të studentëve për tregun ndërkombëtar të punës.

Harmonizimi që arrihet në Evropë me përfshirjen e modelit arsimor në dy nivele/cikle në kuadër të Procesit të Bolonjës i kontribuon zhvillimit të këtij modeli jashtë Evropës. Kështu, p.sh., Universiteti në Grac dëshiron të paraqitet si institucion “mikpritës” (eng. Welcoming) me ofertë, e cila do të jetë konkurruese në nivel ndërkombëtar.

² Nocioni “mësimdhënie” përdoret si përgjithësim i të gjitha formave të mësimin, sikurse janë ligjëratat, ushtrimet, etj. (Aneksi 2 § 4)

**Procesi i Bolonjës është
reformë e strukturës
studimore**

Suksesi i Procesit të Bolonjës në Universitetin e Gracit mund të matet me atë se në çfarë mase ka arritur ky universitet të adoptojë impulset me të rëndësishme të Procesit të Bolonjës, si dhe standardet dhe orientimet. Si shembull mund të përmendet edhe përfshirja e sistemit të akumulimit të ECTS, kalimi në sistemin e bazuar në dy cikle kryesore: themelore dhe postdiplomike, adaptimi i ofertave studimore, zhvillimi i studimeve të përbashkëta me universitetet partnere ndërkombëtare, mbajtja e procesit mësimor në disa gjuhë dhe, para së gjithash, sjellja dhe zbatimi i perspektivës ndërkombëtare në studime, në hulumtime dhe në arsim të mëtejshëm.

Elementet bazë të sistemit ciklor dhe modular

2.1. Modeli i cikleve

Studimet për diplomë përbëhen nga 180 ECTS kredi, gjë që përputhet me kohëzgjatjen e studimeve prej gjashtë semestrash. Studimet e rregullta në arsimimin themelor shkencor kanë për qëllim aftësimin, respektivisht përgatitjen e studentëve për profesionin e tyre të ardhshëm. Studimet për diplomë do të duhej të ekzistonin në mënyrë të pavarur nga ato postdiplomike, të cilat paraqesin avancimin e tyre, me ç'rast theksohen dy modele:

Modeli i parë: Synimet arsimore krijohen përmes modeleve të gjera studimore, të cilat ofrojnë arsimim të përgjithshëm nga lënda e caktuar (p.sh., biologjia) apo nga fusha të caktuara (p.sh., shkencat natyrore). Synimi i drejtpërdrejtë i arsimimit sipas këtij modeli për tregun e punës ka të bëjë me kompetencat e përgjithshme dhe me kualifikimet akademike, të cilat u mundësojnë studentëve të veprojnë. Studimet e këtilla janë të bazuara në arsimimin reflektues dhe kanë për qëllim që studentëve "t'ua mësojnë procesin e të mësuarit". Tregu potencial i punës është heterogjen dhe ekziston mundësia për përgjigje në kërkesat e tij me arsimimin shtesë, fleksibil e të përqendruar në nevojat e punës praktike.

Një studim për diplomë, i konceptuar në mënyrë të këtillë, i jep një profil tjetër universitetit: e ofron atë, në aspektin e studimeve praktikisht të zbatueshme, me universitetet e shkencave të aplikuara.

Modeli i dytë: Arsimimi gjatë studimeve për diplomë është profesional dhe ofron specializim të lartë. Lidhshmëria e drejtpërdrejtë me praktikën ka për qëllim aftësimin e studentëve për fushën e caktuar të punës, kërkesat e së cilës reflektohen në kualifikimet të cilat i fitojnë ata me këtë studim. Ky model i studimeve ofron arsimim akademik, i cili kualifikon për profesionin e mëtutjeshëm. Ofertat e këtilla studimore në Evropë duhet t'i kushtojnë rëndësi të veçantë ofertave që ekzistojnë në universitetet e shkencave të aplikuara.

Studimi postdiplomik (Master) përfshin 60-120 ECTS kredi, gjë që përputhet me kohëzgjatjen e studimeve Një studim i këtillë mund të paraqesë ose vazhdimësi të studimeve për diplomë të ngjashme (të fushës së njëjtë), ose të ekzistojë

**Arsimimi i përgjithshëm
në disiplinën
profesionale**

Specializimi

Studimet Postdiplomike

Orientimet ndër-profesionale dhe hulumtuese

në mënyrë të pavarur nga niveli i mëhershëm i arsimimit dhe të jetë i koncentruar në një fushë studimore plotësisht të pavarur, në parim të specializimit të lartë.

Synimi i kualifikimeve të studimeve postdiplomike duhet të jetë shkencor-hulumtues dhe më i thellë, apo drejtpërdrejt i orientuar në profesionin përkatës. *Studimet me orientim profesional janë veçanërisht interesante për studentët, të cilët, pas përfundimit të studimeve themelore dhe pas periudhës së punësimit, dëshirojnë të fitojnë kualifikime shtesë. Përmbajtja e studimeve mund të jetë e ndërlidhur me disiplinën e caktuar shkencore, apo e konceptuar në formë ndërdisiplinore.*

2.2. Profesionet, kompetencat, profili kualifikues dhe synimet arsimore

Synimet e studimeve universitare të orientuara në arsimimin e përgjithshëm dhe profesional

Programet studimore universitare i shërbejnë si arsimimit të përgjithshëm, ashtu edhe arsimimit profesional, i cili i dallon nga studimet e profilit të lartë profesional në universitetet e shkencave të aplikuara. Cilësia e arsimimit universitar është marrëdhënia me hulumtimet, të cilat bëhen në universitete. Prandaj, tashmë është tradicionale se për përgatitjen përmbajtjesore dhe për strukturimin e studimeve është vendimtare njohuria profesionale e fituar përmes pjesëmarrjes në hulumtime. Ndërlidhur me këtë mund të flitet për modelin “nga lart-poshtë” (eng. top-down); kurrikuli paramendohet ashtu që lëndëve të caktuara u definohet përmbajtja, të njëjtat pastaj ofrohen gjatë periudhave të caktuara të studimeve.

Procesi i Bolonjës: ndryshimet në konceptin e studimeve

Megjithatë, Procesi i Bolonjës ka pasur ndikim në ndryshimet substanciale në këto procese. Sipas rregullave, studimet për diplomë duhet të sigurojnë kualifikime për fushën profesionale gjatë zhvillimit të konceptit të studimeve ku, përpos drejtimit profesional, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë kompetencave dhe kualifikimeve të nevojshme për fushat përkatëse profesionale. Në këtë mënyrë, në qendër të vëmendjes më nuk qëndrojnë vetëm faktorët e të dhënave gjegjësisht faktorët e të hyrave (eng. Input) të lëndëve të caktuara, por njëkohësisht edhe faktorët e rezultateve (eng. Output), përkatësisht dija e cila ofrohet me studime dhe me të cilën studentët duhet të jenë të pajisur në çdo rast pas përfundimit.

Faza e parë e zhvillimit të kurrikulit për një studim të këtitllë (modeli nga poshtë-lart, eng. Bottom-Up), përfshin hulumtimin e specifikave dhe të nevojave të fushës së dhënë profesionale, dhe atë përmes bisedave me studentë, me punëdhënës dhe me institucione që merren me këto fusha të veprimit, etj. Në bazë të rezultateve të një hulumtimi të këtitllë, zhvillohet profili kualifikues, i cili definon kompetencat dhe kualifikimet që duhet t'i posedojë një student/e i/e diplomuar. Në këtë profil hyjnë jo vetëm kompetencat profesionale, por edhe ato shoqërore, të ashtuquajtura "shkathtësi të buta" (eng. Soft skills).

Në bazë të profilit kualifikues dhe në pajtueshmëri me nevojat profesionale, definohen synimet arsimore të studimit të përgjithshëm dhe fazat e saj të veçanta, respektivisht modulet. Vetëm në bazë të këtyre vendimeve lidhur me përmbajtjen e studimit është e mundur të ndërmerren hapa konkretë në strukturimin e studimeve (ndarja e numrit të caktuar të ECTS-kredive të moduleve të veçanta dhe të lëndëve, përcaktimi i formës së ligjëatave dhe mënyra e vlerësimit të njohurive dhe të aftësive).

2.3. Formulimi i kompetencave nëpërmjet qëllimeve dhe rezultateve të të nxënës

Përfshirja e sistemit me model dyciklor shkakton ndryshime të shumta në proces të të mësuarit dhe të mësimit. Aplikimi i sistemit ECTS, i cili nxit krahasueshmërinë në studime, parasheh vëllimin e kohës së investuar në të mësuar dhe përfshin përshkrimin kualitativ të kompetencave dhe të aftësive të cilat duhet të fitohen. Planifikimi dhe realizimi i mësimit tash orientohet në drejtim të studentëve.

Këto ndryshime, respektivisht "ndryshimi i kahës së studimeve, nga ata të cilët ligjërojnë në atë se çfarë mësojnë, respektivisht synimeve të cilat duhen të arrihen me të mësuarit", tërheqin me vete faktin se tani synimet e të mësuarit qëndrojnë në qendër të kurrikulit.

Studentët, gjatë studimeve, fitojnë:

- Kompetenca profesionale,
- Kompetenca metodologjike,
- Kompetenca shoqërore, dhe
- Kompetenca personale.

Nëpërmjet të tregut të punës deri tek profilet kualifikuese.

Definicioni i synimeve arsimore

Ndryshimi i kahës së studimit

Synimi i të mësuarit është të fituarit e diturisë lidhur me përmbajtjen profesionale

Synimi i të mësuarit, para së gjithash, përshkruhet me kombinimin e përmbajtjeve specifike profesionale dhe me formën e të fituarit të diturisë lidhur me to (identifikimi, analizimi, thellimi, krahasimi, të kuptuarit, interpretimi, etj). Këto përmbajtje janë të ndryshme nëpër nivele të ndryshme të studimit (të thelluara, të përgjithshme dhe dituritë fillestare lidhur me...). Synimi i të mësuarit nuk i përshkruan aktivitetet e profesorit, por vetëm përshkruan synimet që duhet arritur ata të cilët i mëson ai.

Synimet arsimore janë pikësynimet e qëndrueshme të orientimit/të kahes së kurrikulit në synimet e të mësuarit. Ato, megjithatë, i përshkruajnë synimet e studimeve si kompetenca profesionale dhe të përgjithshme, të cilat duhet t'i fitojnë dhe t'i ndërtojnë studentët gjatë studimeve. Këto synime në kurrikul ndahen në nivele të përfshira në semestrat e veçantë, apo në nivelet e kualifikimeve dhe, përfundimisht, në module të veçanta.

Identifikimi i synimeve dhe testimi/ekzaminimi nëpërmjet përmbledhjes

Një strukturë e këtillë dhe nxjerrja e synimeve nga të përgjithshmet dhe nga ato specifiket, mund të matet me lidhjen logjike të synimeve. Përkundër kësaj, ekziston edhe testimi nëpërmjet përmbledhjes, e cila parashtron pyetjen se a përputhet rezultati i të nxëniet me synimet e kurrikulit?

Shembull:

Lënda	Kompetencat	Synimi i të mësuarit	Shembull
<i>Kimi</i>	<i>Të kuptuarit dhe riprodhimi i dijes</i>	<i>Aspektet themelore të teknologjisë kimike, nomenklatura, konventat dhe njësitë</i>	<i>Hyrje në Kimi</i>

2.4. Sistemi modular

Sistemi modular është një unifikim tematik i përmbajtjeve të veçanta të të mësuarit në njësitë e studimit, të cilat janë shqyrtuar dhe janë definuar paraprakisht. Unifikimi është i orientuar në drejtim të kompetencave që duhen të arrihen.

Sistemi modular i studimeve paraqet një instrument të strukturimit të “kaheve” të individualizuara të studimeve dhe promovimit të mobilitetit brendauniversitar dhe ndëruniversitar, më ç’rast hap mundësinë e përfundimit të moduleve apo komponenteve të tyre në ndonjë fakultet apo universitet tjetër.

Moduli është i definuar me synimet e të mësuarit, me kompetencat dhe me aftësitë të cilat duhet t’i fitojnë studentët. Kjo është një njësi përmbajtjesore e kornizuar, e cila përbëhet nga disa ligjërata. Hapësira kuantitative e modulit matet me ECTS-kredi. Shembujt për formësim të kurrikulit në sistemin modular janë të paraqitura në Shtojcën 2.

Synime të shumta janë të ndërlidhura me sistemin modular të kurrikulit:

- *Në njërën anë, konstrukti i sistemit modular të studimeve përherë e më tepër po shndërrohet në një model evropian të studimeve, synimi i të cilit është të arrihet mobiliteti i studentëve dhe të lehtësohet njohja e ndërsjellë e studimeve dhe e pjesëve të tyre.*
- *Në anën tjetër, sistemi modular ka për qëllim integrimin përmbajtjesor të lëndëve, dhe në këtë mënyrë ofron sinergji të reja në kuptim të përputhshmërisë dhe të përqendrimit të ligjëratave në veçanti/të ndara, në kuadër të një moduli.*

Në anën organizative, sistemi modular mundëson shkëmbimin e përmbajtjes së të mësuarit ndërmjet dy kurrikuleve të ndryshme. Njëri nga kushtet themelore për shkëmbim të moduleve ndërmjet disa kurrikuleve, është marrëveshja e komisioneve përgjegjëse për kurrikul dhe e organeve të tjera përgjegjëse për madhësinë/kapacitetin dhe për përmbajtjen e tyre.

Doracak për zhvillimin e studimeve të rregullta (bachelor) dhe post-diplomike (master)

Synimet e të mësuarit si orientues

Synimet e sistemit modular

Shkëmbimi i moduleve

Moduli, si rezultat i pjeshëm i studimit

Përfundimi i një moduli mund të pranohet si kualifikim i pavarur nga studimi i përgjithshëm (p.sh., moduli themelor). Prandaj, do të duhej që përfundimi i secilit modul të dokumentohet me certifikata, ashtu që studentët të mund t'i paraqesin kualifikimet e tyre edhe jashtë universitetit në të cilin i kanë fituar ato.

2.5. Moduli i përgjithshëm

(i paraqitur në bazë të modelit të Universitetit Karl-Franzens në Grac, Austri)

Orientimi në studimet themelore

Në planin zhvillimor të Universitetit Karl-Franzens në Grac, moduli i përgjithshëm është definuar si një ndër 16 projektet strategjike. Moduli i përgjithshëm ofron inovacione të rëndësishme në lëmin e të mësuarit dhe i përket studimeve për diplomë në këtë universitet. Modul i përgjithshëm janë ligjëratat për ata që i fillojnë studimet dhe për ndjekjen e këtyre ligjëratave nuk është e nevojshme të përmbushin ndonjë kusht të specifikuar. Në aspektin përmbajtësor, këto ligjëratat ofrohen në forma që janë lehtë të kuptueshme. Ato lehtësojnë orientimin gjatë studimeve për diplomë, ndërsa, ata të cilët e kalojnë këtë deri në fund, arrijnë të pajisen me certifikatë për vijimin e tyre të suksesshëm.

Moduli i përgjithshëm përfshin gjithsej 30 ECTS-kredi, prej të cilave 6 ECTS-kredi i takojnë lëndëve që janë në kuadër të lëndëve të lira zgjedhore³ dhe ku mund të zgjedhin të gjithë studentët e universitetit përkatës. 24 ECTS-kredi të tjera të mbetura mbeten në dispozicion për lëndët e tjera profesionale, ndërdisiplinare dhe për lëndë të tjera. Në secilin fakultet ekzistojnë një apo më tepër module të përgjithshme, të cilat ofrojnë dituri themelore për përmbajtjet profesionale apo për përmbajtjet e përgjithshme. Në këtë mënyrë, studentëve u mundësohet të fitojnë njohuri në disiplina të ndryshme profesionale dhe të fitojnë kompetenca shtesë, si në përmbajtjet profesionale të studimeve të tyre, po ashtu edhe në tema të tjera të ndryshme. Me modulin e përgjithshëm përmirësohet "depërtimi" i studimeve dhe lehtësohet bartja eventuale në drejtime apo në fakultete të tjera.

³ V. Aneksi 2 (5)

Për komisionet dhe për organet që marrin vendime për kurrikulin, zbatimi i modulit të përgjithshëm nënkupton përputhshmëri të ndërsjellë të lëndëve të ndërlidhura dhe koncipim të ofertës së përbashkët.

2.6. Mundësia e shfrytëzimit të medimeve

Mediumet e reja mund të integrohen në mënyra të ndryshme në mësimin që është i bazuar në praninë e studentëve. Prandaj, janë në dispozicion edhe koncepte të ndryshme:

Koncept i pasurimit të diturisë

Koncepti i pasurimit të diturisë: Ky koncept mundëson që mësimi klasik, i bazuar në praninë e studentëve, të jetë i ndihmuar me materiale që janë të qasshme në internet (online) dhe të materialeve që kanë informata për përmbajtjen e lëndëve dhe informata administrative. Këto materiale përgatiten nga profesorët. Komunikimi ndërmjet studentëve dhe profesorëve nuk zhvillohet nëpërmjet shfrytëzimit të medimeve. Përmbajtja mësimore ende zhvillohet me ligjëratë, të cilat nënkuptojnë praninë e studentëve. Në këtë rast, një vlerë të rëndësishme për studentët paraqesin mundësitë fleksibile të qasjes në materiale dhe përkrahja për fitim të njohurive.

Shembuj: Materialet mësimore janë në dispozicion online, foliet prezantuese, ushtrimet për kontrollimin e diturisë nga vetë studenti.

Koncepti i Integruar nënkupton ekzistimin si të fazës së pranisë në ligjëratë ashtu edhe të fazës online, në bazë të të cilave ato ndërmarrin detyra specifike që janë në përputhshmëri të ndërsjellë. Proceset interaktive të komunikimit më nuk janë të kufizuara vetëm në pjesë të ligjëratës, që nënkupton praninë e studentëve, por, bashkërisht, me shpërndarjen e informatave, paraqesin edhe elementin qendror, fazën online. Nëse shfrytëzohet ky koncept, lëndët nuk mund të përfundohen me sukses pa shfrytëzimin e rregullt të internetit.

Koncepti i integruar plotëson konceptin e plotësimit të diturisë:

Shembuj: Komunikimi ndërmjet studentëve, ndërmjet studentëve dhe profesorëve, zgjidhja grupe e detyrave, përkrahja individuale dhe këshillimi nga ana e profesorëve nëpërmjet e-mailave, forumeve, chat-eve, audio dhe video konferencave, vlerësimi i punës dhe i dijes së studentëve nëpërmjet shfrytëzimit të medimeve.

Koncepti virtual nënkupton faza të kufizuara të pjesëmarrjes/të pranisë në ligjëratë/mësim. Paraqitja e ligjëratës virtuale rekomandohet vetëm në raste kur është vështirë të organizohet pjesëmarrja në ligjëratë për shkak të distancës gjeografike të studentëve, apo për shkak të kufizimeve kohore të shkaktuara nga punësimi i studentëve.

*Koncepti virtual e zgjeron konceptin e integruar.
Shembuj: Konferencat virtuale, telegjëratat.*

3. Formësimi profesional dhe përmbajtësor i kurrikulit

3.1. Hulumtimet e kërkesave arsimore

Mësimi shkencor në universitete mbahet me qëllim të arsimimit të studentëve. Detyra e tij është të ofrojë një shkollim me baza themelore shkencore dhe me metoda të cilat janë të nevojshme për veprimtari profesionale të studentëve pas studimeve. Për këtë arsye, fillimisht, është e domosdoshme të hulumtohen kërkesat arsimore në mënyrë që, në bazë të tyre, mësimi t'i përshtatet kërkesave të shkencës dhe kërkesave të tregut të punës.

Kërkesat arsimore duhet të hulumtohen në bazë të disa metodave të njohura, si p.sh. "Metoda Delfi" (e njohur si studimi Delfi, ose hulumtimi Delfi).⁴ Mirëpo, është e mundshme të shfrytëzohen edhe metoda të tjera të vlerësuara empirike.

3.2. Tri shtyllat e një kurrikuli

Tri shtyllat e një kurrikuli janë të paraqitura në shembullin e Universitetit Karl-Franzens në Grac.

Lëndët janë të ndara në lëndë të obliguara dhe në lëndë zgjedhore. Lëndët obligative janë ato që i definojnë studimet. Lëndë zgjedhore i quajmë ato lëndë të cilat mund t'i zgjedhin studentët sipas kushteve të definuara në kurrikul (tërësitë e lëndëve zgjedhëse), ose mund t'i zgjedhin në çfarëdo universiteti të pranuar (lëndë të lira zgjedhore).

⁴ *Sritter FT, Tresolini, CP, Reeb KG: The Delphi Technique in Curriculum Development. Teaching and Learning in Medicine. 1994;6(2):136-141.*

Në aspektin përmbajtjesor çdo kurrikul përbëhet nga tri shtylla:

- *Lëndët kryesore,*
- *Lëndët për thellim/zgjerim/avancim ose përcaktim të rëndësisë, dhe*
- *Lëndët plotësuese.*

Lëndët kryesore


Lëndët kryesore përfshijnë përmbajtjet profesionale qendrore të kurrikulit. Ato ngërthejnë diturinë themelore dhe profesionale. Elementet shtesë të tyre janë konceptet teorike qendrore, hulumtuese dhe praktike, si dhe metodat e gjenerimit të njohurive shkencore.

Lëndët “thelluese”

Lëndët për thellim ose për theksimin e rëndësisë janë të fokusuara në njohuri më të specializuara, fusha të caktuara speciale dhe/ose në pyetje hulumtuese. Parimisht, punimi i diplomës, në fund të studimeve, edhe për nga përmbajtja e edhe për nga forma, është i lidhur me lëndët për thellim ose për theksimin e rëndësisë.

Lëndët plotësuese

Lëndët plotësuese përfshijnë fusha si, p.sh., teknikat/metodat e punës shkencore dhe metodat e veçanta të disiplinave relevante, përmbajtjen e disiplinave të ngjashme, lëndët e përgjithshme themelore, siç janë: gjuhët e huaja, matematika, statistika, lëndët sociale, strategjia e të mësuarit, menaxhimi individual i diturisë, etj. Përveç kësaj, lëndët plotësues përfshijnë edhe disa lëndë, të cilat ofrohen edhe në fakultete të tjera.



Pjesa e ECTS-kredive, e paraparë për lëndët zgjedhore, nuk mund të kalojë gjysmën e ECTS-kredive të parapara për studime të caktuara.

3.3. Formësimi i modulit

Volumi i çdo moduli dokumentohet me numrin e ECTS-kredive që përmban ai. Secilës komponentë në kuadër të një moduli i janë përcaktuar kompetenca të caktuara dhe aftësitë (rezultatet e të nxënit) si dhe ECTS-kreditë, në mënyrë që të sigurohet transparencë për shkak të kërkesave, shkallëve të kualifikimit dhe volumit të punës që pritet prej studentëve.

Madhësitë e rekomanduara të modulit janë të ndashme si, p.sh., në 6-8-10-12 ECTS-kredi. Modulet më tepër se 15 ECTS-kredi nuk janë gjithëpërfshirëse. Modulet duhet të ofrohen në periudhë të parashikuar kohore, në formën organizative dhe didaktike, e cila është më e mira për studentët

Barazimi i madhësive të modulit nuk është i mundshëm, nuk do të kishte kuptim, mirëpo mund të ekzistojë një marrëveshje për madhësinë e tyre të përafërt. Kjo rekomandohet në ato raste kur ekziston mundësia e ndërrimit të moduleve dhe komponenteve të tyre ndërmjet kurrikuleve të ngjashme, si dhe në pjesën e moduleve zgjedhore dhe të moduleve të përbashkëta që ngjajnë më tepër në kurrikule.

Doracak për zhvillimin e studimeve të rregullta (bachelor) dhe post-diplomike (master)

**Volumi i moduleve:
ECTS-kreditë**

Parimet e ndarjes

Madhësitë e përafërta të modulit

Përshkrimi i kurrikulit në module


Përmbajtja e modulit duhet të klasifikohet në këto kategori: lëndët kryesore, lëndët për “thellim/avancim/zgjerim dhe lëndët plotësuese-shtesë. Përshkrimi i modulit në kuadër të kurrikulit përfshin: emrin e modulit, lëndën e modulit, kompetencën, qëllimet e të mësuarit, numrin e ECTS-kredive, numrin e orëve “kontaktuese”, klasifikimin e përmbajtjes së modulit, nivelin, semestrin e mbajtjes së modulit, mënyrat e të pyeturit.

“Dritarja për mobilitet”

Në mënyrë që të fillohet dimensionimi ndërkombëtar i studimit gjatë konceptimit të kurrikulit, rekomandohet që në kuadër të planifikimit të semestrit të lihet hapësirë kohore për mobilitet dhe të përcaktohet se cilat module, gjegjësisht cilat ligjërata rekomandohet të kryhen jashtë shtetit.


Të njëjtat ligjërata mund të shfrytëzohen në disa module. Gjatë kësaj duhet pasur kujdes për konsistencën e nivelit të studimeve, për përmbajtjen e tyre dhe të ECTS-kredive.

Shembuj të formësimit të modulit



Modulin ndërdisiplinar e karakterizon bashkimi i përmbajtjes së modulit prej fushave të ndryshme të kurrikulit.

Dy lëndë, prej fushave nga lëndët kryesore, kombinohen me një lëndë gjegjëse prej fushës së lëndëve për thellim (ose vendosjes së qëllimit) dhe me një lëndë plotësuese. Në mënyrë që të formohet profili i kurrikulit, modulet ndërdisiplinare janë veçanërisht të pëlqyeshme për formimin e qendrës praktike ose përmbajtjesore.



Ky lloj moduli përbëhet prej dy moduleve të fokusuara në lëndë profesionale, prej të cilëve njëri është modul kryesor, ndërsa tjetri modul plotësues. Qëllimi i modulit kryesor është dhënia e dijenisë profesionale nga fushat e caktuara, gjersa moduli plotësues ka të bëjë me teknika të punës.

Kombinimi i lëndëve të ndryshme i ofron qasje të ndryshme didaktike dhe metodike përmbajtjes profesionale. Disa ligjërata në kuadër të këtyre moduleve mund ta plotësojnë njëra-tjetrën, por nuk do të thotë që gjithsesi ta bëjnë këtë.

3.4. Parakushtet për hyrje në module dhe ligjëratat në kuadër të moduleve

Njohuritë paraprake

Kurrikuli mund të përmbajë kërkesë për argumentim të dijes paraprake (vlerësimi pozitiv në një ose më shumë lëndë, gjegjësisht ndonjë formë tjetër e argumentimit për parakualifikim) si parakusht për paraqitjen për ligjërata, për përcjelljen e të cilave kërkohen kushte të posaçme. Nëse për lëndë të caktuara kërkohet dije paraprake,

atëherë në kurrikul duhet definuar llojin e argumenteve, apo duhet dhënë dëshmi të tjera lidhur me njohuritë paraprake të nevojshme për të vijuar këto lëndë.

Dëshmia e tyre, së bashku me regjistrimin e semestrit, paraqet parakusht për pranimin e studentëve në këto ligjërata, gjegjësisht për afrimin e tyre në lëndët e ngjashme.

4. Studimet në kuadër të ECTS-sistemit (European Credit Transfer System and Accumulation System)

Sistemi evropian i dëshmimit, i përcjelljes dhe i akumulimit të ECTS-kredive, është sistem i studimit i orientuar nga studenti. Është i bazuar në të ashtuquajturin *Workload*⁵ dhe është i domosdoshëm për arritjen e qëllimeve të një programi të caktuar të mësimin.

Sistemi ECTS ka filluar në vitin 1989, në kuadër të programit ERASMUS (i cili ndërkohë u shndërrua në pjesë të programit SOCRATES). Në fillim është shfrytëzuar për pranimin e rezultateve të studimit. Sistemi ka shërbyer për lehtësimin e dëshmisë së qëndrimit në botën e jashtme në kuadër të studimeve dhe të përmirësimit të mobilitetit studentor në Evropë.

Me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës, në qershor të vitit 1999, ECTS është krijuar si një prej elementeve kryesore të harmonizimit të strukturës së studimeve evropiane. ECTS është zhvilluar në instrument transferimi dhe akumulimi të rezultateve të arritura gjatë studimeve.

Rezultatet e reja të funksionit ECTS kanë ndërruar rrënjësisht perspektivën e të kuptuarit të arsimimit universitar dhe synimet e studimeve i vendosin nga perspektiva e studentëve dhe, si parakusht, përfundimi i studimeve matet me kohën që ia kushtojnë studimit vetë studentët.

Qëllimi i ECTS është transparenca, krahasimi i programeve të studimeve dhe i diplomave, si dhe njohja e ndërsjellë e diplomave dhe e kualifikimeve.

⁵ Angazhimi dhe koha e përkushtimit të studentëve për arritjen e synimeve të programit të mësimin.

Sistemi ECTS

ECTS: Sistem për transferim dhe akumulim

Orientimi me qendër të studentët

Qëllimet politiko-educuese

ECTS plotëson dy funksione kryesore:

**Funksionet e ECTS:
transferimi dhe
akumulimi**

Nga njëra anë, ECTS është sistem për transferim të rezultateve studimore, i cili lehtëson mobilitetin e studentëve dhe përmirëson shkëmbimin e ndërsjellë të universiteteve.

Nga ana tjetër, ECTS është sistem për akumulim të rezultateve të studimeve, siguron transparencë dhe krahasim të programeve të studimeve. Ndarja e ECTS-kredive e lejon krahasimin e rezultateve të studentëve të drejtimeve të ndryshme të studimeve dhe siguron njohjen akademike të rezultateve të studimit dhe të dijës së fituar jashtë studimeve tradicionale të studimit (eng. Life Long Learning).

**Vëllimi i studimeve i
shprehur me ECTS-kredi**

Përveç kësaj, ECTS definon vëllimin e studimeve dhe informon për kohën që i nevojitet studentit mesatar për kryerjen e të gjitha studimeve dhe pjesëve të tyre. Kur janë arritur kualifikimet e duhura dhe të vërtetuara, studentit i pranohen kreditë që i përkasin lëndës së caktuar, ose modulit. Studimet konsiderohen të kryera në momentin kur plotësohen të gjitha kushtet dhe kur përcaktohen të gjitha pjesët e ECTS-kredive.

**Definicioni i
ECTS-kre-dive**

Në Austri, gjegjësisht sipas Ligjit austriak për universitetet, të vitit 2002, ECTS-kreditë janë të definuara si pjesë relative "workload" - ngarkesës së punës - e lidhur me rezultatet e caktuara studimore ashtu që angazhimi në punë "workload" gjatë një viti duhet të jetë 1.500 orë dhe i cili shpërblehet me 60 ECTS-kredi. Ky definicion është krijuar në bazë të konceptit, sipas të cilit kreditë paraqesin madhësinë relative për llogaritjen e punës së kryer. Fakti që në prapavijë të kësaj llogaritjeje duhet të jenë 1.500 orë pune, hap mundësinë e llogaritjes së volumit të punës së studentëve në bazë të llogaritjes absolute (1 kredi = 25 orë).

**Kompetencat dhe
aftësitë (eng. Earning
Outcomes/ Rezultatet e
të nxënit)**

ECTS-kreditë janë shprehje e angazhimit në punë, mirëpo nuk paraqesin përmbajtjen e tyre dhe as kompetencat e arritura. Për këtë, në kurrikul, së bashku më njësitë studimore (lëndët/modulet), përveç kohës së angazhimit të studentëve, duhet të jenë të përshkruara edhe kompetencat dhe aftësitë (eng. Learning Outcomes/rezultatet e të nxënit)

Ideali i qëndrueshmërisë

Përveç kësaj, vëllimi real i lëndës, i angazhimit të pritur dhe i rezultateve të domosdoshme për kryerjen me sukses të një ligjërate të caktuar, gjegjësisht të modulit, duhet të jetë në përputhje me kohën e cila investohet për arritjen e tyre.

Doracak për zhvillimin e studimeve të rregullta (bachelor) dhe post-diplomike (master)

Vëllimi i punës përfshin të gjitha veprimtaritë që janë pjesë e një studimi dhe të cilat testohen me ndihmën e verifikimit të diturisë dhe të aftësive:

- Vijimi i ligjëratave (numri i të ashtuquajturave “orë kontaktuese”);
- Praktika;
- Studimi vetanak dhe mësimi;
- Përgatitja e provimeve;
- Punimet përfundimtare dhe provimet.

Me “orë kontaktuese” nënkuptohet koha gjatë së cilës takohen gjatë ligjëratave profesorët dhe studentët.

Koha e domosdoshme që duhet t’i kushtohet një ligjërate të caktuar, gjegjësisht një moduli apo lëndë, vlerësohet me rastin e zhvillimit të kurrikulit. Çdo ligjëratë, gjegjësisht çdo modul/lëndë, bazohet në aktivitetet e ndryshme që mund të merren për bazë gjatë llogaritjes së kohës së nevojshme:

- a) Ligjëratat;
- b) Përmbajtja mësimore: prania e obligueshme në ligjërata, puna e vazhdueshme gjatë kurseve, ushtrimet, ushtrimet laboratorike, punët teknike, shkrimi i punimeve, përgatitja e referateve, leximi, etj.
- c) Forma e provimit: provimet me shkrim ose me gojë, referatet, punimet me shkrim, raportet, etj.

Në çdo kurrikul duhet të përcaktohet mekanizimi për vlerësimin e kohës së investuar, ashtu që të mund të kompensohen shmangiet prej kohës së investuar.

Aftësitë që duhet të arrihen përshkruhen si për gjithë kohën e studimeve, ashtu edhe për module dhe lëndë të caktuara.

Për këtë duhet të merren parasysh tri elemente:

1. Cilat njohuri i bie studenti me vete?
2. Cilat njohuri dhe aftësi mund t’i arrijë studenti pas 25 orëve të investuara sipas ECTS-kredive në kuadër të vëllimit të një studimi të definuar?
3. Për cilat profesione dhe për cilat role në shoqëri duhet ta përgatisë studentin studimi i caktuar?

Në kuadër të Procesit të Bolonjës, sistemi ECTS është futur si instrument që përmban kredi dhe vlerësime me qëllim të vlerësimit të rezultateve akademike studimore në botën e jashtme. Derisa kreditë reflektojnë kohën e deponuar, notat informojnë për kualitetin e punës.

Doracak për zhvillimin e studimeve të rregullta (bachelor) dhe post-diplomike (master)

Vëllimi i punës

Orët kontaktuese

Ngarkesa e punës (eng. Workload)

Kompetencat dhe aftësitë

Llogaritja e rezultateve studimore nga bota e jashtme

Sistemi ECTS i vlerësimit është i zhvilluar me qëllim të llogaritjes së vlerësimit që ka dhënë universiteti në të cilin studentët kanë qenë mysafirë. Ai paraqet informatë shtesë për rezultatet e arritura, mirëpo nuk zëvendëson sistemin e vlerësimit të bazuar në kritere, siç është kriteri lokal.

Meqenëse shkalla kombëtare e vlerësimit të ECTS nuk ekziston, vetë universitetet vendosin për sistemin e vlerësimit ECTS. Vlerësimi i suksesit studimor në Grac është i definuar me Statutin e Universitetit.

Përmbledhje

Llogaritja e ECTS-kredive:

- Shpërndarja e ECTS-kredive është e bazuar në kohën që ka investuar studenti;
- Koha të cilën studentët e investojnë përfshin të gjitha aktivitetet e që janë pjesë e studimeve;
- “Orët kontaktuese” paraqesin vetëm një pjesë të kohës së deponuar;
- Koha e investuar është 1.500 orë në vit (1 orë = 60 minuta).
- Kohës së angazhimit prej 1.500 orëve vjetore i përgjigjen 60 ECTS-kredi;
- 1 vjet = 1.500 orë = 60 ECTS-kredi;
- 1 semestër = 30 ECTS-kredi;
- 1 ECTS (njësia më e vogël ndarëse nuk do të mund të ishte nën 0,5) = 25 orë.

Shpërndarja e ECTS-kredive:

1. Përvetësimi i njohurive dhe i aftësive të përcaktuara me njësitë mësimore janë të definuara, ndërsa aktivitetet e përcaktuara janë të listuara;
 2. Në bazë të kësaj përcaktohet numri i orëve që duhet deponuar. Sa kohë i nevojitet një studenti mesatar që t’i kryejë detyrat e dhëna?
 3. Llogariten edhe “orët kontaktuese” (përcjellja e ligjëratave);
 4. Shuma e të gjitha orëve të nevojshme e jep shumën e përgjithshme të orëve, gjatë së cilës 1 ECTS-kredi paraqet 25 orë pune angazhim.
- P.sh., 75 orë të angazhimit në punë paraqesin 3 ECTS-kredi
 - 125 orë të angazhimit paraqesin 5 ECTS-kredi.

Në asnjë rast, numri i orëve të investuara nuk guxon të llogaritet me gjatësinë e ligjëratave gjatë semestrit

5. Rregullorja e provimeve

Rregullorja e provimeve definohet me kurrikul dhe paraqet pjesët e saj, duke definuar llojin e provimit, mënyrën e pyetjes, metodën e pyetjes dhe, përafërsisht, përshkrimin e mënyrës së provimit.

5.1. Llojet e provimeve

Në kurrikul definohet se a mbahen provimet gjatë studimeve për diplomë dhe për provimet e postdiplomës në formën e provimeve të lëndës, provimeve profesionale apo provimeve të përgjithshme.

Qëllimi i provimit të lëndës është që studentët të tregojnë njohuritë dhe aftësitë e përfituara nga ligjëratat e caktuara. Në ligjëratat, në fillim të semestrit, studentët duhet të informohen saktësisht për kriteret e vlerësimit. Provimin e lëndës e mban ligjëruesi i asaj lënde. Nëse është e nevojshme, prorektori/prodekani mund të caktojë edhe pyetësit (testuesit) shtesë profesionale.

Qëllimi i provimit profesional është të tregohet aftësia dhe dija në një fushë të caktuar profesionale, ndërsa provimet e gjithëmbarshme kanë për qëllim të tregojnë dijen dhe aftësinë në më tepër fusha.

Edhe provimi profesional, por edhe provimet e përbashkëta, mund të mbahen në formë të provimit individual, të cilin e mban një pyetës që i pyet studentët para komisionit.

5.2. Metodatat pyetëse

Provimet me gojë janë provime në të cilat studentët u përgjigjen pyetjeve gojarisht. Provimet me gojë janë publike dhe numri i studentëve të pranishëm varet prej hapësirës që është në dispozicion.

Provimi i lëndës

Provimi profesional

Provimi individual dhe me komision

Provimet me gojë

Provimet me shkrim Provimet me shkrim janë provime në të cilat kërkohen përgjigje me shkrim.

Punimet seminarike Punimet seminarike janë praktike, eksperimentale, teorike, ose të shkruara në kuadër të provimit.

5.3. Mënyra e të pyeturit

Mënyra e të pyeturit afërsisht definohet me kurrikul dhe është e lejuar edhe në rastet kur rregullat e caktuara janë të definuara me statut.

Paraqitja e provimeve Paraqitjet për provime, për provimet profesionale dhe për provimet e përgjithshme, merren parasysh kur janë përmbushur të gjitha parakushtet: regjistrimi i semestrit gjegjës dhe parakushtet e tjera të definuara në kurrikul për paraqitjen e provimit të caktuar.

Afatet e provimeve Afatet e provimeve duhet të parashihen në fillim, në mes, ose në fund të semestrit. Data konkrete e provimit mund të kërkohet edhe gjatë paraqitjes për provim.

Afatet e provimeve për lëndët, sipas rregullave, duhet të ofrohen gjatë semestrit të tretë, gjegjësisht pas përfundimit të ligjëratave. Provimet në parim i mban ligjëruesi i asaj lënde. Për provime profesionale dhe për lëndë të përbashkëta mund të dorëzohen lutjet për mbajtjen e provimit të ligjëruesi i caktuar.

Lutja për përcaktimin e datës së provimit dhe të pyetësit E drejta në lutje për caktimin e datës së një provimi dhe përcaktimi i anëtarëve të komisionit pyetës më së shumti ka të bëjë më paraqitjen e provimeve të përbashkëta. Këtyre kërkesave mundësisht duhet përmbajtur.

Materialet e shfrytëzuara:

1. Deklarata e Bolonjës, e Pragës, e Berlinit, e Londrës
2. Pjesë nga Ligji austriak për universitetet (UG 2002)
3. Pjesë nga Statuti: Rregullat e studimeve
4. Studimi i fizibilitetit buxhetor
5. Përkujtues për ndryshim të kurrikulit ekzistues dhe krijimit të kurrikulit të ri
6. Ueb-linçet:

Bolonja dhe zhvillimi i kurrikulit

<http://www.uni-graz.at/lss/lehrservice>

Procesi i Bolonjës

http://www.uni-graz.at/bibwww/bibwww_strategicfocus/bibwww_bologna-process.htm

Dokumente (Deklarata e Sorbonës, Deklarata e Bolonjës, Raporti i Pragës, Raporti i Berlinit, Raporti i Bergenit)

http://www.uni-graz.at/bibwww/bibwww_strategicfocus/bibwww_bologna-process/bibwww_bologna.htm

Nisma e Përbashkët e Cilësisë

<http://www.jointquality.org/>

Projekti: Tuning Educational Structures in Europe

<http://tuning.unideusto.org/tuningeu/>

Tuning: Module Planing Form

<http://www.socrates-leonardo.fr/upl/documents/Tuning.doc>

Konferenca e Rektorëve të Universiteteve të Zvicrës (CRUS):
Konceptet për përshkrim dhe shpjegim të kompetencave në fushën e edukimit

<http://www.crus.ch/deutsch/lehre/bologna/index.htm>

ECTS, faqja e Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare e KF Universitetit në Graz

http://www.uni-graz.at/bibwww/bibwww_strategicfocus/bibwww_bologna-process/bibwww_ects.htm

ECTS Users Guide

http://europa.eu.int/comm/education/programmes/socrates/usersg_en.html

Trends IV (Raport për implementimin e Procesit të Bolonjës)

http://www.eua.be/eua/jsp/en/upload/TrendsIV_FINAL.1117012084971.pdf

Trends III (Raport për implementimin e Procesit të Bolonjës)

<http://www.eua.be/eua/jsp/en/upload/Trends2003final.1065011164859.pdf>

European Universities Association (EUA)

<http://www.eua.be>

European Network for Quality Assurance in Higher Education (ENQA)

<http://www.enqa.net>

Qëllimi i “Doracakut për zhvillimin e studimeve themelore (bachelor) dhe postdiplomike (master)” është që të ndihmoj stafin akademik të Universitetit të Prishtinës për zhvillimin e plan programeve (kurrikulave) në përputhje me Deklaratën e Bolonjës dhe me trendët e fundit evropiane në arsimin e lartë. Ky doracak do të jetë shoqërues i vlefshëm gjatë zhvillimit të plan programeve (kurrikulit) për Universitetin e Prishtinës me qëllim që të ofrohet një arsim i lartë cilësor, i krahasueshëm dhe konkurrent në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.



financed by

Austrian
 **Development Cooperation**